



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

VENDIM

Nr. 24/2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 86/2018  
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIN E  
PAGAVE TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 37 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të vendimit të Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ndryshohet sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Miratuar në datën 23.3.2023

KRYETAR SHQIPËRISË

Lindita NIKOLLA



Lidhja nr. 1



Lidhja nr. 2

**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS TË ZYRËS SË  
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**

| <b>Funksioni</b>   | <b>Nr. i punonjësve</b> | <b>Kategoria/Klasa</b>                           |
|--|-------------------------|--|
| <b>I. Komisioneri</b>  | <b>1</b>                | I-D Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, i ndryshuar |
| <b>II. Kabineti</b>  | <b>( 3 )</b>            | VKM 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar            |
| Drejtor  | 1                       | II - a   |
| Këshilltar   | 1                       | II - b   |
| Zëdhënës   | 1                       | II - b   |
| <b>III. Sekretar i Përgjithshëm</b>                                      | <b>1</b>                | I - b  |
| <b>IV. Njësia Auditit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</b>           | <b>( 2 )</b>            |  |
| Inspektor  | 2                       | III - a  |
| <b>V. Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit</b>           | <b>( 15 )</b>           |  |
| Drejtor i Përgjithshëm   | 1                       | II - a   |
| <b>V/I. Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës</b>       |                         |  |
| Drejtor  | 1                       | II - b   |
| Inspektor  | 5                       | III - a  |
| <b>V/II. Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave</b>                          |                         |  |
| Drejtor  | 1                       | II - b   |
| Inspektor  | 5                       | III - a  |
| <b>V/III. Sektori për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik</b>      |                         |  |
| Inspektor  | 2                       | III - a  |
| <b>VI. Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</b> | <b>( 20 )</b>           |  |
| Drejtor i Përgjithshëm   | 1                       | II - a   |

**VI/I. Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit**

|           |   |         |
|-----------|---|---------|
| Drejtor   | 1 | II - b  |
| Inspektor | 6 | III - a |

**VI/II. Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave**

|           |   |         |
|-----------|---|---------|
| Drejtor   | 1 | II - b  |
| Inspektor | 6 | III - a |

**VI/III. Drejtoria e Mbikëqyrjes në fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë Publike**

|           |   |         |
|-----------|---|---------|
| Drejtor   | 1 | II - b  |
| Inspektor | 4 | III - a |

**VII. Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritimit (7)**

|         |   |        |
|---------|---|--------|
| Drejtor | 1 | II - b |
|---------|---|--------|

**VII/I. Sektori Rregullator, Integritimit dhe Procedurave Administrative**

|              |   |         |
|--------------|---|---------|
| Shef sektori | 1 | III - a |
| Inspektorë   | 2 | III - a |

**VII/II. Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë**

|              |   |         |
|--------------|---|---------|
| Shef sektori | 1 | III - a |
| Specialistë  | 2 | III - b |

**VIII. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës (11)**

|         |   |        |
|---------|---|--------|
| Drejtor | 1 | II - b |
|---------|---|--------|

**VIII/I. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun**

|                                     |   |         |
|-------------------------------------|---|---------|
| Shef sektori                        | 1 | III - a |
| Specialist IT                       | 1 | III - b |
| Specialist për burimet njerëzore    | 1 | III - b |
| Specialist për marrëdh. me publikun | 1 | III - b |

|                      |   |                                       |
|----------------------|---|---------------------------------------|
| Nëpunës informacioni | 1 | Kl. II (VKM nr. 234, datë 20.04.2022) |
|----------------------|---|---------------------------------------|

### **VIII/II. Sektori i Shërbimeve dhe Financës**

|                                     |           |                 |                                |
|-------------------------------------|-----------|-----------------|--------------------------------|
| Shef sektori                        | 1         |                 | III - a                        |
| Specialist financë – buxhet         | 1         |                 | III - b                        |
| Specialist redaktor/protokoll/arkiv | 1         |                 | IV - a                         |
| Magaznier/shofer                    | 1         | Kl. V           | (VKM nr. 234, datë 20.04.2022) |
| Punonjës Pastrimi                   | 1         | Kl. I           | (VKM nr. 234, datë 20.04.2022) |
| Gjithsej                            | <b>60</b> | <b>punonjës</b> |                                |